



NË KOSOVË DHE NË MBARË BOTËN KU KA SHQIPTARË PO VAZHDOJNË PROTESTAT KUNDËR VENDIMIT TË GJYKATËS SPECIALE

KOSOVA E DIASPORA NË KËMBË PËR ÇLIRIMTARËT: S'KEMI ME U NDALË DERI NË LIRIMIN E TYRE

-Në ditën e 5-të protestave shpaloset flamuri gjigant kuqezi me emblemën e UÇK-së për çlirimtarët



Qytetarët në Prishtinë janë mbledhur për të pestën natë me radhë për të kundërshtuar aktgjykimin e Gjykatës Speciale. Protestat tashmë janë shndërruar në tubime të përnatshme, me

qytetarët që kundërshtojnë verdiktin e 16 shtatorit, me të cilin Gjykata Speciale dënoi me burgim ish-krerët e UÇK-së. Protestuesit e konsiderojnë këtë vendim të padrejtë, të ndikuar politikisht dhe

të rrezikshëm për shtetin e Kosovës. Në këto protesta, mesazhi i qytetarëve dhe diasporës është i qartë: Kosova e diaspora në këmbë për çlirimtarët: S'kemi me u ndalë deri në lirinë e tyre

AKTUALE



GARA PËR IA: KAZAKISTANI PËRBALLET ME PRESION PËR TË ZGJEDHUR MES SHBA-SË DHE KINËS

F. 2

NJERIU I 17 SHKURTIT NËN HIJEN E 16 SHTATORIT

F. 3

KURTI NË NJU-JORK: DO TË ANGAZHHEMI PËR KORRIGJIMIN E VERDIKTIT NDAJ ISH-KRERËVE TË UÇK-SË

F. 6

RAMA FLET PËR PROTESTAT PËR GAZETËN GJERMANE: SHQIPËRIA NUK SHITET

F. 6



EKONOMI



HAP I RI PËR BIZNESET KOSOVARE, KOSOVA PJESE E ATA CARNET

F. 7

INDUSTRIA NË KOSOVË RRIKET 12,47 PËR QIND NË KORRIK

F. 7

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht-Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +389 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

GARA PËR IA: KAZAKISTANI PËRBALLET ME PRESION TË ZGJEDHUR MES SHBA-së DHE KINËS



ASTANA, 20 SHTATOR - Shtetet e Bashkuara dhe Kina kanë ndërmarrë nisma për të ndikuar në të ardhmen e Inteligjencës Artificiale (IA) dhe Kazakistani mund të detyrohet të zgjedhë njërin palë. Si i vetmi vend që i është bashkuar si nismës amerikane Pax Silica, ashtu edhe Organizatës së Kinës për Bashkëpunim në Inteligjencën Artificiale (WAICO), politika e tij e jashtme po përballet me presion të ri, ndërsa Uashingtoni dhe Pekini garojnë për ndikim teknologjik. Pozita e pazakontë e Kazakistanit ka tërhequr vëmendjen e Uashingtonit, teksa Shtetet e Bashkuara përpunon të kufizojnë ndikimin e Kinës në teknologjinë e IA-së dhe zinxhirët e furnizimit të saj. Agjencia Reuters raportoi muajin e kaluar se Qeveria amerikane po përgatitej t'u thoshte dhjetëra vendeve se duhet të zgjedhin mes nismave konkurruese për IA-në. Një draft-letër e Departamentit amerikan të Shtetit, të cilën e ka parë Reuters, paralajmëroi se vendet që i bashkohen kornizës rivale të Kinës mund të përjashtohen nga koalicioni i udhëhequr nga SHBA-ja. “Të jesh pjesë e gjithçkaje do të thotë të mos jesh pjesë e asgjëje”, thuhet në draft-letër, ku përshkruhet pjesëmarrja në Pax Silica si një angazhim dhe jo thjesht si anëtarësim. Në kohën kur u raportua për të, draft-letra nuk ishte dërguar dhe nuk ka asnjë të dhënë se Uashingtoni i ka kërkuar kërkuar zyrtarisht Kazakistanit të

tërhiqet nga ndonjëra prej këtyre nismave. Por, mesazhi vë në pah vështirësinë në rritje për vende si Kazakistani, që synojnë të ruajnë lidhjet ekonomike dhe teknologjike me të dyja fuqitë. Ndërkaq, Kina ka kundërshtuar idenë se vendet duhet të detyrohen të zgjedhin njërin palë. Ambasada e saj në Uashington i bëri thirrje SHBA-së të ndalojë nxitjen e shteteve që të zgjedhin vetëm një nismë dhe të shmangë politizimin e çështjeve të tregtisë dhe teknologjisë. Presioni vjen në një kohë kur IA-ja po ndërlidhet gjithnjë e më shumë me sigurinë kombëtare, industrinë, energjinë dhe infrastrukturën. Pax Silica, e lansuar nga Uashingtoni në dhjetor të vitit 2025, përqendrohet në sigurimin e zinxhirëve të furnizimit për mineralet kritike, gjysmëpërçuesit, energjinë, qendrat e të dhënave dhe infrastrukturën kompjuterike të nevojshme për ekonominë e bazuar në IA. Aktualisht, kjo nismë ka 25 nënshkrues, përfshirë Bashkimin Evropian, Japoninë dhe Singaporin. Kazakistani e nënshkroi deklaratën më 25 qershor, duke u bërë vendi i parë i Azisë Qendrore që iu bashkua nismës. WAICO, ndërkaq, u themelua në Shanghai më 16 korrik, ndërsa 29 vende nënshkruan marrëveshjen për krijimin e organizatës. Anëtarët e saj përfshijnë Kinën, Rusinë, Kazakistanin, Uzbekistanin, Kirgizinë, Taxhikistanin, Pakistanin, Indonezinë dhe Brazilin.

Organizata thotë se synon të nxisë bashkëpunimin ndërkombëtar për qeverisjen, standardet dhe zhvillimin e IA-së, si dhe që të zvogëlojë hendekun teknologjik mes vendeve.

Një ekuilibër i kujdesshëm

Për Kazakistanin, secila prej këtyre nismave ofron mundësi të ndryshme. Uashingtoni ka thënë se Pax Silica synon të krijojë zinxhirë të besueshëm furnizimi që përfshijnë mineralet, gjysmëpërçuesit, prodhimin, energjinë dhe infrastrukturën e IA-së. Kjo mund t'i sigurojë vendit qasje në investime, teknologji dhe partneritete në zinxhirët e furnizimit të udhëhequra nga SHBA-ja. Kazakistani, i cili ka rezerva të mëdha mineralesh kritike, të nevojshme për teknologjitë e avancuara dhe infrastrukturën e IA-së, është një aleat i rëndësishëm për këtë nismë. Ndërkaq, WAICO i ofron Kazakistanit një rol në një kornizë të mbështetur nga Kina për bashkëpunimin ndërkombëtar në fushën e IA-së. Pekini ka promovuar modele të inteligjencës artificiale si alternativa më të qasshme për vendet që nuk mund t'i përballojnë ose nuk kanë qasje në sistemet kryesore. Kazakistani thotë se pjesëmarrja në të dyja kornizat është në përputhje me politikën e tij të jashtme. Presidenti kazak, Qasym-Zhomart Toqayev, tha në

një intervistë për agjencinë kineze të lajmeve Xinhua se inteligjenca artificiale duhet t'i shërbejë njerëzimit dhe se vendet duhet të kenë qasje fer në teknologjitë moderne. Duke iu referuar pjesëmarrjes së Kazakistanit në WAICO, Toqayev tha: “Qasjet tona përputhen me qëndrimin e Kinës për këtë çështje”, duke e përshkruar këtë hap si pjesë të përpjekjeve drejt një “sistemi ndërkombëtar të hapur dhe efektiv” për koordinimin e përpjekjeve në fushën e inteligjencës artificiale. Ky ekuilibër i ka shërbyer Kazakistanit prej vitesh. Vendi i pasur me burime natyrore ka ruajtur lidhje të ngushta ekonomike me Kinën, teksa ka kultivuar njëkohësisht marrëdhëniet me Shtetet e Bashkuara dhe Evropën. Astana ka kërkuar investime perëndimore në sektorët e energjisë dhe minierave, duke mbetur thellësisht e lidhur me Rusinë dhe Kinën fqinje.

Partnerë të besueshëm

Por inteligjenca artificiale mund ta ngushtojë hapësirën për manovrim. Ndryshe nga tregtia tradicionale, inteligjenca artificiale përfshin gjithnjë e më shumë infrastrukturë strategjike, kompjuterizim të avancuar, qendra të të dhënave, gjysmëpërçues dhe teknologji që mund të kenë edhe përdorim ushtarak. Uashingtoni po sinjalizon se dëshiron që vendet që marrin

pjesë në ekosistemin e tij të inteligjencës artificiale të jenë partnerë të besueshëm dhe jo thjesht pjesëmarrës tregtarë. “Është e vështirë të shihet se si një vend mund ta pozicionojë veten si partner i besueshëm në një ekosistem teknologjik, ndërkohë që njëkohësisht i bashkohet një nisme të dizajnuar nga Kina për të avancuar një vizion konkurrues për inteligjencën artificiale”, i tha një zyrtar amerikan Reutersit.

Rezervat e Kazakistanit me minerale kritike ia shtojnë rëndësinë në zinxhirin e furnizimit në zhvillim për inteligjencën artificiale, ndërsa pozita e tij gjeografike e bën një partner të rëndësishëm në Azinë Qendrore. “Nuk mendoj se Astana bëri gabim duke iu bashkuar të dy blloqeve. Por, duket se Astana llogariti gabim një gjë: Me sa duket, nuk priste që Uashingtoni të vendoste një vijë të kuqe dhe t'i thoshte Kazakistanit se duhet të zgjidhte mes dy blloqeve”, tha për Radion Evropa e Lirë analisti Wilder Alejandro Sanchez, president i kompanisë me bazë në Uashington, Second Floor Strategies.

Ai sugjeroi se Astana mund të kërkojë bisedime me Uashingtonin, duke bërë të qartë se nuk dëshiron të zgjedhë mes SHBA-së dhe Kinës. Për momentin, Kazakistani nuk është detyruar të bëjë këtë zgjedhje. Por, gara që po zhvillohet sugjeron se politika e tij tradicionale shumëvektoriale mund të përballet me një provë më të vështirë në teknologji sesa në fusha të tjera.

Pyetja për Astanën mund të jetë jo thjesht se me cilat vende tregton, por se në cilin ekosistem teknologjik mbështetet për të ndërtuar infrastrukturën e tij të inteligjencës artificiale.

Aftësia e Kazakistanit për të ruajtur lidhjet si me Uashingtonin, ashtu edhe me Pekinin mund të jetë në vetvete një aset për Shtetet e Bashkuara, tha Ken Moriyasu, bashkëpunëtor i lartë në Institutin Hudson. Ai argumentoi se fleksibiliteti i Astanës ndihmon në ruajtjen e rëndësisë së vendit për strategjinë amerikane në Euroazi. “Ky qëndrim shumë fleksibil i Kazakistanit është shumë i dobishëm për strategjinë e SHBA-së”, i tha Moriyasu The Astana Times. “Mbajtja e Kazakistanit si aleat dhe partner të besueshëm në këtë përpjekje është më e rëndësishme sesa detyrimi i tij për të zgjedhur njërin palë në Pax Silica”, tha ai.

NJERIU I 17 SHKURTIT NËN HIJEN E 16 SHTATORIT

Dënimi për krime lufte i shton një kapitull të ri trashëgimisë së Hashim Thaçit, një prej figurave qendrore të pavarësisë dhe shtetndërtimit të Kosovës. Juridikisht, aktgjykimi ndaj Thaçit nuk prek pavarësinë e Kosovës; politikisht, ekspertët paralajmërojnë se mund të përdoret për të sfiduar narrativën e shtetësisë së saj. Nga partneriteti me Perëndimin te verdikti në Hagë, si do të bashkëjetojnë këta dy kapituj në mënyrën se si do të kujtohen Thaçi dhe historia e re e Kosovës?

PRISHTINË, 20 SHTATOR - Më 17 shkurt 2008, Hashim Thaçi qëndroi në foltoren e Kuvendit të Kosovës dhe lexoi fjalët që do ta përcaktonin vendin e tij në historinë e shtetit më të ri të Evropës. “Ne, udhëheqësit e popullit tonë, të zgjedhur në mënyrë demokratike, nëpërmjet kësaj deklarate, shpallim Kosovën shtet të pavarur dhe demokratik”, tha Thaçi.

Ai ishte atëherë 40 vjeç, kryeministër i Kosovës dhe ish-udhëheqës politik i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Fotografia e tij në Kuvend u bë një nga imazhet përcaktuese të 17 shkurtit. Tetëmbëdhjetë vjet më vonë, një tjetër imazh i Thaçit hyn në historinë e Kosovës. Më 16 shtator 2026, ai qëndroi në një sallë gjyqi në Hagë dhe dëgjoi një trup gjykues të Dhomave të Specializuara të Kosovës ta shpallte fajtor për krime lufte. “Trupi gjykues ju dënon me një dënim të njësuar me 25 vjet burgim”, u tha në aktgjykim. Asnjëra fotografi nuk e fshin tjetrën, por, prej këtij aktgjykimi, ato do të ekzistojnë së bashku. Pyetja është se çfarë i bën kjo jo vetëm trashëgimisë së Thaçit, por edhe mënyrës se si do të lexohet historia e shtetit që ai ndihmoi ta krijonte.

Çfarë gjykoj Haga?

Mark Ellis, drejtor i Odës Ndërkombëtare të Avokatëve, thotë se përgjigjja juridike nuk lë shumë hapësirë për dilemë: këto janë dy çështje krejtësisht të ndara.

Sipas tij, Dhomat e Specializuara kishin për detyrë të përcaktonin përgjegjësinë penale të katër individëve - Thaçit dhe bashkëluftëtarëve të tij, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit - dhe jo të gjykonin shtetin që u krijua më vonë. “Ata i shpallën këta katër individë fajtorë për krime lufte dhe për përgjegjësinë e tyre individuale. Kjo është ajo që përcakton ligji. Nuk do të duhej të kishte ndonjë ndikim tjetër mbi shtetin”, thotë Ellis për Radion Evropë e Lirë.

Për pavarësinë, përgjigjja juridike u dha edhe vite më parë. Më 2010, Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë konstatoi se Deklarata e 17 shkurtit nuk e shkeli të drejtën ndërkombëtare. Vija u tërhoq qartë edhe në Dhomat e Specializuara: synimi për pavarësinë e

Kosovës nuk ishte objekt i përgjegjësisë penale. Aktgjykimi trajtoi krimet e kryera ndaj personave të perceptuar si kundërshtarë të UÇK-së. Megjithatë, ajo që ndahet qartë në një sallë gjyqi, mund të bashkohet më lehtë në betejën politike për historinë.

Një aktgjykim që mund të marrë një jetë tjetër

Pikërisht këtu, sipas studiuesit Abit Hoxha nga Universiteti Agder në Norvegji, aktgjykimi mund të marrë një jetë tjetër. Jo duke ndryshuar statusin juridik të Kosovës, por duke hyrë në përplasjen shumë më të vjetër për mënyrën se si interpretohet pavarësia e saj. Hoxha thotë se vendimi mund të lërë “një njollë të madhe” në këtë histori dhe pret që Serbia dhe Rusia, të cilat vazhdojnë ta kundërshtojnë pavarësinë e Kosovës, ta përdorin dënimin e Thaçit për të sfiduar narrativën mbi të cilin Kosova e ka ndërtuar shtetësinë e saj dhe për ta shtyrë këtë interpretim edhe përtej tyre. “Vendet sikurse Qiproja, Rumania, Spanja, Greqia... do ta kenë shumë më të vështirë ta njohin pavarësinë e Kosovës, për shkak të këtij argumenti. Të gjithë njerëzit që janë kundërshtarë të Kosovës, do të thonë se themeli i shtetit të Kosovës është bërë mbi krime të luftës. Këtu është rreziku më i madh që unë e shoh”, thotë Hoxha për programin Expose të Radios Evropa e Lirë. Për vetë figurën e Thaçit, Hoxha përdor një përkufizim më të fortë. Ai e përshkruan si “babain e pavarësisë së Kosovës” - jo vetëm për faktin se lexoi Deklaratën, por për rolin që kishte në gjithë procesin që çoi deri tek ajo. Është një rol që, sipas Hoxhës, aktgjykimi mund ta komplikojë, por nuk mund ta fshijë nga historia.

Kjo për faktin se rruga e Thaçit përshkoi disa prej etapave vendimtare të historisë së re të Kosovës.

Nga veprimtaria politike dhe roli udhëheqës në UÇK, ai kaloi në negociatat ndërkombëtare për Kosovën dhe, pas luftës, në krye të institucioneve të saj. Ishte kryeministër kur u shpall pavarësia, më vonë president dhe një nga figurat kryesore në dialogun me Serbinë dhe në marrëdhëniet me Perëndimin.

DY MËNYRA PËR TA KUJTUAR THAÇIN

Por, kjo histori e gjatë politike ngre edhe pyetjen se sa mund të ndahet aktgjykimi i Hagës nga trashëgimia e Thaçit.

Për studiuesin Armend Bekaj nga Universiteti Uppsala në Suedi, mënyra se si do të kujtohet Thaçi nuk ka vetëm një përgjigje. “Për shumikë, Hashim Thaçi do të vazhdojë të jetë heroi i luftës dhe i paqes, por, njëkohësisht, edhe për shumikë do të jetë një person, i cili u shpall fajtor për krime lufte. Besoj që kjo gjykatë, fatkeqësisht, ka ofruar material të bollshëm për politikanin, akademikun, gazetarin e sotëm, e nesërm, që të shkruajë vëllime të tëra si për njërin ekstrem, ashtu edhe për ekstremin tjetër”, thotë Bekaj për Exposenë. Për ata që do ta lexojnë Thaçin vetëm përmes aktgjykimit, Bekaj shton se duhet kujtuar edhe konteksti: rruga e tij nga UÇK-ja deri te pavarësia u përshkua me mbështetje të fuqishme të Perëndimit, mbi të gjitha të Shteteve të Bashkuara. Si dëshmi të këtij raporti, ai përmend edhe paraqitjen në mbrojtje të Thaçit të ish-zyrtarëve të lartë amerikanë, si Wesley Clark dhe James Rubin. “Hashim Thaçi dhe liderët e tjerë të UÇK-së, dhe jo vetëm të UÇK-së, kanë qenë partnerë në çdo hap - prej kohës së rezistencës civile, rezistencës së armatosur drejt bërjes së Kosovës shtet - kanë punuar në një afërsi të jashtëzakonshme me miqtë euroatlantikë”, thotë Bekaj.

A duhet Perëndimi ta rilexojë atë periudhë?

Ky partneritet e zgjeron pyetjen përtej vetë Thaçit. Nëse ai ishte një nga figurat kryesore me të cilat Shtetet e Bashkuara dhe aleatët e tyre punuan në rrugën drejt pavarësisë, a e detyron aktgjykimi i Hagës Perëndimin ta rilexojë edhe atë periudhë? Charles Kupchan, ish-zyrtar i Këshillit të Sigurisë Kombëtare të Shteteve të Bashkuara dhe profesor në Universitetin Georgetown, nuk mendon kështu. “...sepse Thaçi e bëri atë kalim, apo jo? Nga një udhëheqës i kohës së luftës, i dënuar tani për mizori, ai u bë një udhëheqës civil që ndihmoi Kosovën të



ecte drejt pavarësisë dhe të ndërtonte marrëdhëniet e saj me Shtetet e Bashkuara, me fuqitë evropiane dhe me të tjerët. Prandaj, nuk mendoj se kjo do të ndryshojë”, thotë Kupchan për Exposenë. Me fjalët e tij, verdikti mund të jetë një tronditje afatshkurtër, por jo një goditje që do të ndryshojë pozitën ndërkombëtare të Kosovës. Ai nuk pret tërheqje të njohjeve, dëmtim të partneriteteve me Perëndimin apo pengim të rrugës euroatlantike. Sipas tij, as procesi i normalizimit me Serbinë nuk vihet në pikëpyetje. Madje, në planin afatgjatë, ai sheh mundësinë edhe të një efekti pozitiv, nëse procesi shihet si dëshmi se drejtësia zbatohet njësoj për të gjithë. “Kosova po luftonte për t’u mbrojtur nga spastrimi etnik dhe, për këtë arsye, lufta për pavarësi ishte një luftë e drejtë. Megjithatë, një luftë e drejtë nuk i justifikon krimet e luftës. Një padrejtësi nuk mund të arsyetohet me një padrejtësi tjetër. Nëse Thaçi dhe pjesëtarë të tjerë të UÇK-së kanë kryer krime lufte - edhe pse kauza për të cilën luftonin ishte e drejtë - atëherë mendoj se gjykata ka bërë atë që duhej të bënte”, thotë Kupchan.

Nga “George Washingtoni i Kosovës” te Haga

Ky kontrast nuk kaloi pa u vënë re edhe jashtë Kosovës. Në raportimet për aktgjykimin, mediat ndërkombëtare e përshkruan Thaçin jo vetëm si ish-president dhe ish-udhëheqës të UÇK-së, por edhe si një nga figurat qendrore të pavarësisë. AFP-ja e përmbloodhi transformimin në një titull: “Nga ‘George Washingtoni i Kosovës’ në të dënuar në Hagë”. Krahasimi lidhet me një përshkrim që Joe Biden kishte përdorur për Thaçin gjatë kohës kur ishte nënpresident i Shteteve të Bashkuara. Associated Press kujtoi se Thaçi, i cili u kthye nga Zvicra

për t’iu bashkuar luftës në Kosovë, u pranua më pas nga udhëheqësit perëndimorë, mori pjesë në negociatat e Rambujesë më 1999 dhe u pa si një prej figurave që mund ta udhëhiqnin Kosovën drejt pavarësisë. Guardian shkroi se Thaçi, dikur me qëndrime të ashpra, më pas u zhvendos drejt një profili politik më të moderuar. The Times, po ashtu, e përmbloodhi kontrastin që në titull: “‘Gjarpri’, hero i Kosovës, i dënuar për krime lufte”.

Një trashëgimi që tash ka dy anë

Kur pyetet se cili imazh i Thaçit do të peshojë më shumë pas disa dekadash - njeriu që ndihmoi ta çonte Kosovën drejt pavarësisë apo njeriu i dënuar për krime lufte - Kupchan nuk zgjedh mes tyre. “Si edhe me udhëheqës të tjerë që kanë bërë gjëra të guximshme dhe me vlerë, por që njëkohësisht janë akuzuar edhe për vepra penale, përfshirë krime lufte, edhe në rastin e Thaçit ekzistojnë të dyja anët. Është një trashëgimi e ndërlikuar. Thaçi do të kujtohet për rolin që kishte në udhëheqjen e Kosovës drejt pavarësisë. Por, në të njëjtën kohë, trashëgimia e tij tash do të jetë e lidhur edhe me këtë aktgjykim”, thotë Kupchan. Dy momentet i ndajnë pak mbi 18 vjet.

Se cili prej tyre do të peshojë më shumë në mënyrën se si do të kujtohet Thaçi, mbetet një pyetje për vitet që vijnë. Por, 16 shtatori nuk ndryshoi vetëm trashëgiminë e tij. Në të njëjtën sallë, Jakup Krasniqi u dënua me 25 vjet burgim, Kadri Veseli me 18 dhe Rexhep Selimi me 13 - të gjithë për krime lufte. Në Kosovë, aktgjykimi u prit me reagime të forta dhe me shpresën se fjala e fundit mund të mos jetë thënë ende. Sepse, pas më shumë se tre vjetësh gjykim dhe një aktgjykimi që dha gjithsej 81 vjet burgim për katër ish-udhëheqësit e UÇK-së, vëmendja tash zhvendoset tek apeli.



NË KOSOVË DHE NË MBARË BOTËN KU KA SHQIPTARË PO VAZHDOJNË PROTESTAT KUNDËR VENDIMIT TË GJYKATËS SPECIALE

KOSOVA E DIASPORA NË KËMBË PËR ÇLIRIMTARËT: S'KEMI ME U NDALË DERI NË LIRIMIN E TYRE

-Në ditën e 5-të protestave shpaloset flamuri gjigant kuqezi me emblemën e UÇK-së për çlirimtarët

Qytetarët në Prishtinë janë mbledhur për të pestën natë me radhë për të kundërshtuar aktgjykimin e Gjykatës Speciale. Protestat tashmë janë shndërruar në tubime të përnatshme, me qytetarët që kundërshtojnë verdiktin e 16 shtatorit, me të cilin Gjykata Speciale dënoi me burgim ish-krerët e UÇK-së. Protestuesit e konsiderojnë këtë vendim të padrejtë, të ndikuar politikisht dhe të rrezikshëm për shtetin e Kosovës. Në këto protesta, mesazhi i qytetarëve dhe diasporës është i qartë: Kosova e diaspora në këmbë për çlirimtarët: S'kemi me u ndalë deri në lirimin e tyre



për ish-krerët çlirimtarë. Flamuri është mbajtur nga dhjetëra pjesëmarrës, ndërsa përreth tij ishin grumbulluar protestues të tjerë. Protestuesit brohoritnin "UÇK" dhe emrat e ish-udhëheqësve të UÇK-së, ndërsa në duar mbanin pankarta me mbishkrime kundër vendimit të gjykatës. Protestat në përkrahje të çlirimtarëve kanë vazhduar edhe në shtetet evropiane dhe

në ShBA. Mërgimtarë të shumtë shqiptarë protestuan në kryeqytetin e Austrisë pasditen e së dielës në kundërshtim të aktgjykimit dënues të Gjykatës Speciale ndaj drejtuesve të UÇK-së, Hashim Thaçit, Jakup Krasniqi, Kadri Veseli dhe Rexhep Selimi. Në këtë protestë në Vjenë mbizotëruan thirrjet "Liria ka emër", "Jo në emrin tim" dhe

EPOKA E RE

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 20 SHTATOR - Për të pestën natë me radhë, qytetarë të shumtë u mbledhën të dielën në sheshet kryesore të Prishtinës për të protestuar kundër dënimit me burgim ndaj katër ish-eporëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës në Hagë. Në mesin e protestuesve ishin edhe familjarë të ish-krerëve të UÇK-së që u dënuan më 16 shtator. Në ditën e pestë të protestave, është shpalosur flamuri gjigant kuqezi me emblemën e UÇK-së





“Liri për çlirimtarët e Kosovës”. Protesta ka pasur edhe në shtete të tjera të Evropës.

Deputetja e PDK-së, Ariana Musliu-Shoshi, ka thënë se krahas mbështetjes së fuqishme të shqiptarëve kudo që janë, kthesën e madhe mund ta sjellë vetëm shteti, përmes veprimit të unifikuar dhe përgjegjësisë institucionale.

“Krahas mbështetjes së fuqishme të shqiptarëve kudo që janë, kthesën e madhe mund ta sjellë vetëm shteti, përmes veprimit të unifikuar dhe përgjegjësisë institucionale. Dhe këtë duhet ta bëjnë dy shtetet bashkë: Kosova dhe Shqipëria. Ky nuk është momenti për heshtje, pritje apo deklarata formale. Është momenti për veprim

shtetëror, diplomaci aktive dhe angazhim maksimal. Koha nuk pret. Shteti duhet të veprojë. Tani”, ka thënë Shoshi.

Azem Syla, ish-komandant i Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së, i shoqëruar nga disa bashkëluftëtarë, ka vizituar të dielën familjet e Hashim Thaçit, Jakup Krasniqit dhe Kadri Veselit, për t’u shprehur përkrahje dhe solidaritet të plotë në këtë sfidë, e cila nuk është vetëm e tyre, por e mbarë kombit.

Syla do t’i vizitojë edhe familjet e bashkëluftëtarëve të tjerë. Edhe kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Bedri Hamza, ka vizituar familjet e Hashim Thaçit, Kadri Veselit dhe Jakup Krasniqit, pas

vendimit të fundit të Dhomave të Specializuara në Hagë.

Hamza ka bërë të ditur përmes një postimi në rrjete sociale se gjatë këtyre vizitave u ka shprehur familjeve mbështetjen e tij.

Ai ka theksuar se familjet e ish-krerëve të UÇK-së “nuk janë vetëm dhe nuk do të jenë kurrë”. Sipas Hamzës, dhimbja që po përjetojnë familjet është edhe dhimbje e popullit të Kosovës. Kreu i PDK-së ka shprehur gjithashtu krenarinë e tij për ish-krerët e UÇK-së dhe luftën për liri.

Hamza ka sqaruar se nuk ka pasur asnjë qëllim anashkalimi apo ndarjeje politike për ta vizituar edhe familjen e Rexhep Selimit, por ka kontaktuar

familjen e Selimit për të realizuar një takim sapo ata të kenë mundësi.

“Diaspora shqiptare po zgjohet sërish”

Ish-deputeti i AAK-së, Daut Haradinaj, ka thënë se në ditët më të errëta, kur shpresa kërkonte krahë, ishin pikërisht vëllezërit dhe motrat tona në diasporë që u bënë shtylla, zëri dhe mbështetja më e madhe për çlirim. “Sot, diaspora shqiptare po zgjohet sërish me të njëjtin zjarr e përkushtim. Edhe një herë po e dëshmojnë me vepra, me zë të lartë e me zemër të hapur, se nuk janë vëzhgues të historisë, por gardianë të saj. Ata po na tregojnë se janë me ne,

me lirinë, me shtetin tonë dhe me çlirimtarët që dhanë gjithçka për këtë ditë. Po, Liria Ka Emër, e ka edhe emrin edhe Mërgatë, e ka emrin sakrificë dhe ka prapa cep një popull të tërë, këtu e në çdo cep të botës, që sot po e mbron Luftën Çlirimtare, UÇK-në, me krenari dhe dinjitet.

Faleminderit, diaspora jonë! Kur jemi bërë bashkë, asnjë sfidë nuk na ka thyer dot, dhe as sot nuk do të na thyejë”, ka shkruar Haradinaj në rrjetet sociale.

Të martën e 22 shtatorit në ora 18:00 do të mbahet një protestë para ndërtesës së OKB-së në Nju-Jork të ShBA-ve. Kjo protestë është thirrur nga pjesëtarët e komunitetit shqiptaro-amerikan.



DËNIM RACIST



Muhamet MAVRAJ

Kur kam thënë herën e fundit në një televizion tonin se “më shumë shpresoj sesa besoj” në shkallën e parë të Hagës (EULEX-it), kisha parasysh ato që i kam thënë dhjetëra herë në këto vite: gjyqtarët kundër dhe fort, prokurorët kundër, avokati i “viktimizeve” kundër, avokati i “popullit” i asaj gjykate edhe ai kundër, qeveria si kjo ma - këmbë e krye kundër, heshtja ndërkombëtare kundër. Ata të vetëm. Kaq e thjeshtë. Kishte gjithçka aty, veç drejtësi Jo. Mirë e dinim.

Dhe kaq humor e tallje: kreu i rastit, plakushi 81-vjeçar, eulexian i njohur për racizmin antishqiptar qysh moti, Smithi III, mori lejen nga prorusja Trendafilova, të ia urojë vetes përvjetorin e lindjes, dhe si kurorëzim të karrierës: pikërisht me 81 vjet i dënoi krerët shqiptarë. Mbase edhe si shpullë për një 81-sh tjetër. Sidoqoftë, ndonëse e rëndë, në emër të “popullit të Kosovës”, duke buruar nga Kushtetuta e kësaj Kosove, i dha vetes të drejtë kjo gjykatë të thotë se pavarësia dhe vete ajo Kushtetutë, ka edhe meritën kriminale se nuk do të bëhej realitet. Po pra, spiuna, shteti ishte në gjyq! Për mirënjohje, ky vetëdemaskim.

Por këtë miturakun me flamur në shpinë nuk mund ta ktheni në përralla më. Mbaron detyrat e marra nga shkolla, merr flamurin dhe shkon në tjetrën detyrë pa i thënë kush, çdo ditë.

Nuk ka drejtësi që dënon lirinë tonë, kombin dhe shtetet tona shqiptare! Këto gjyqe janë farsa! Ka gjyq mbi gjyq! Dhe ka shqiptar sa të jetë kjo botë!

Absolutisht optimist!



IDENTIFIKOHEN TRI VIKTIMA NGA VARREZAT NË ZUBIN-POTOK, I PËRKASIN ‘GRUPIT TË INTELEKTUALËVE’

PRISHTINË, 20 SHTATOR - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka njoftuar të shtunën se është konfirmuar identiteti i tri viktimave pas zhvarrimit të mbetjeve mortore të zbuluara në varreza masive në lokacione të ndryshme në veri të Kosovës. Kurti shkroi në “Facebook” se raportet e ADN-së kanë konfirmuar se tri viktimat i përkasin grupit të njohur si “Grupi i Intelektualëve”, kryesisht qytetarë nga Skenderaj dhe Mitrovica, të rrëmbyer dhe të zhdukur me dhunë më 19 prill 1999 nga forcat serbe. Grupi prej 23 “intelektualëve” ishte një grup shqiptarësh, mes tyre veprimtarë, profesionistë dhe figura publike nga zona e Mitrovicës, të cilët u zhdukën në zonën e Zubin Potokut më 19 prill të 1999-s. Kryeministri nuk tregoi me emër dhe mbiemër se kush ishin viktimat, por tha se familjet e tri

viktimave të identifikuara janë njoftuar qysh sot. Njoftimi i tij vjen gati dy muaj pasi u zbuluan tri varre masive në këtë komunë në veri të vendit, ku u gjetën mbetje mortore të së paku 23 njerëzve. Në fund të muajit të kaluar, autoritetet kosovare i dërguan në Hagë të Holandës mostrat e mbetjeve mortore të zhvarrosura në lokacionet e varreve masive në Kalludër dhe Jabukë të Zubin Potokut. Kurti tha se Kosova pret t’i pranojë edhe raportet e tjera për mostrat e dërguara për identifikim përmes analizës së ADN-së “në ditët dhe javët në vijim”. “Me shpresën që edhe familjet e tjera të marrin përgjigjet që presin prej 27 vitesh. Asnjë përgjigje nuk mund ta shuajë dhimbjen e humbjes, por njohja e së vërtetës i jep fund ankthit të pritjes për të mësuar fatin e më të dashurve”, tha Kurti.



Varrezat në Zbuin Potok u zbuluan rreth dy muaj më parë pas një hetimi dyvjeçar lidhur me dyshimet për krime lufte, sipas autoriteteve kosovare. Prokuroria Speciale e Kosovës po i heton për këtë rast katër persona, J.R., M.J., R.K dhe M.B., të dyshuar për krime lufte

kundër popullsisë civile. Që të katër ndodhen në paraburgim. Njëri nga të arrestuarit, sipas autoriteteve, dyshohet se në kohën e luftës kishte qenë pjesë aktive e Armatës Jugosllave. Sipas Institutit të Krimeve të Kryera Gjatë Luftës në Kosovë,

1.577 persona vazhdojnë të jenë të zhdukur nga lufta e viteve 1998-1999, ndërsa janë dokumentuar gjithsej 12.230 viktima të luftës. Kosova ka kërkuar vazhdimisht nga Serbia bashkëpunim për zbardhjen e fatit të personave të zhdukur dhe qasje në arkivat ushtarake që sipas autoriteteve mund të ndihmojnë në identifikimin e lokacioneve të varreve të mundshme. Kurti, i cili ndodhet në Shtetet e Bashkuara dhe për sesionin e 81-të të Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së, tha se do t’iu kërkojë Shteteve të Bashkuara, Bashkimit Evropian dhe Britanisë së Madhe, ta shtojnë trysinë ndaj Serbisë për t’i zbatuar zotimet për hapjen e arkivave, për të ndihmuar në gjetjen e vendndodhjes së njerëzve të zhdukur nga lufta e fundit në Kosovë.

KURTI NË NJU-JORK: DO TË ANGAZHOHEMI PËR KORRIGJIMIN E VERDIKTIT NDAJ ISH-KRERËVE TË UÇK-së

NJU-JORK, 20 SHTATOR - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka zhvilluar në Nju-Jork një bashkëbisedim me të rinjtë e diasporës shqiptare në SHBA, me temën “Between Here and Home”, të organizuar nga grupet shqiptaro-amerikane ZANI, F’Oda dhe Columbia University Albanian Society. Kurti ka bërë me dije se në delegacionin e Kosovës, përveç anëtarëve të Qeverisë, janë edhe kryetarja e Preshevës, Ardita Sinani, dhe deputeti Shaip Kamberi. Gjatë takimit, sipas Kurtit, është diskutuar për një sërë çështjesh, përfshirë zhvillimet ekonomike në Kosovë, sistemin e drejtësisë, barazinë gjinore dhe bashkëpunimin mes shqiptarëve në Ballkanin Perëndimor dhe diasporë.

Kurti ka theksuar se ekonomia e Kosovës është rritur me 5.4 për qind në tremujorin e parë të këtij viti, ndërsa ka deklaruar se papunësia është ulur nga 26 për qind në 10 për qind gjatë qeverisjes së tij. Një pjesë e diskutimit i është kushtuar edhe sistemit gjyqësor, për të cilin Kurti ka thënë se nevojiten përmirësime të mëtejshme në integritet dhe performancë, duke iu referuar edhe kritikave të përfshira në raportet ndërkombëtare, përfshirë raportet e Komisionit Evropian. Kryeministri ka folur edhe për vendimin e Dhomave të Specializuara të Kosovës në Hagë ndaj ish-krerëve të UÇK-së. Ai ka deklaruar se Qeveria e Kosovës do të angazhohet për të mbështetur përpjekjet për



kundërshtimin e këtij vendimi. “Qeveria e Republikës së Kosovës është e përkushtuar që të ofrojë mbështetje, në çdo mënyrë dhe me të gjitha mjetet që i ka në

dispozicion, me qëllim korrigjimin e verdiktit të Dhomave të Specializuara ndaj ish-krerëve të UÇK-së, i cili është i padrejtë juridikisht dhe

moralisht dhe i pasaktë historikisht dhe faktikisht”, ka deklaruar Kurti. Ai ka thënë se është e nevojshme një dakordim për një strategji shtetërore lidhur me reagimin ndaj vendimit të shkallës së parë, si në mbështetjen e ekipeve mbrojtëse në instancat e apelit, ashtu edhe në rrafshin diplomatik. “Do të bashkëpunojmë me aleatët tanë ndërkombëtarë, do të angazhohemi pandërprerë në mbrojtjen e luftës sonë çlirimtare përballë propagandave të Serbisë dhe, njëkohësisht, në zbardhjen e masakrave dhe krimeve të tjera të Serbisë në Kosovë”, ka thënë Kurti. Sipas tij, Beogradi zyrtar, edhe më shumë se 27 vjet pas përfundimit të luftës, vazhdon të përpiqet t’i fshehë këto krime.

RAMA FLET PËR PROTESTAT PËR GAZETËN GJERMANE: SHQIPËRIA NUK SHITET

TIRANË, 20 SHTATOR - Protestat e përditshme në Tiranë, të pagëzuara si “Revolucioni i Flamingove”, dhe përplasia politike me Kryeministrin Edi Rama janë bërë pjesë e një artikulli të publikuar nga gazeta prestigjioze gjermane “Frankfurter Allgemeine Zeitung”. Në fokus të shkrimit janë protestat që kanë vijuar prej më shumë se 100 ditësh, por që, sipas artikullit, nuk janë shndërruar në një lëvizje masive në rrugët e kryeqytetit. Përballë kësaj situatë, Rama i sheh protestat si një sfidë për qeverinë, por edhe si një mundësi për të reflektuar mbi mënyrën se si institucionet duhet t’u përgjigjen shqetësimeve të

qytetarëve. “Për mua është një sfidë. Por kjo është diçka e mirë. Gjatë gjithë jetës sime politike, gjërat nuk kanë shkuar kurrë vërtet mirë kur nuk jam sfiduar”, citohet të ketë thënë Rama, duke shtuar se koha do të tregojë nëse edhe kësaj here sfida do ta bëjë më të mirë qeverisjen e tij. Sipas kryeministrit, fakti që qytetarët dalin në rrugë për çështje që lidhen me mjedisin, biodiversitetin dhe interesin publik nuk duhet parë domosdoshmërisht si një zhvillim negativ. Rama argumenton se Shqipërisë i nevojitet një qasje më e madhe ndaj asaj që ai e quan “shtet përkujdesës” – një shtet që dëgjon qytetarët, merr në konsideratë përvojat e tyre dhe

punon për përmirësimin e shërbimeve publike dhe investimeve. Sipas tij, kjo qasje është pjesë edhe e reflektimeve brenda qeverisë dhe grupit parlamentar për mënyrën se si institucionet duhet t’u përgjigjen kërkesave të shoqërisë. Një tjetër pjesë e artikullit lidhet me projektet e investimeve në Zvërnec dhe ishullin e Sazanit, të cilat kanë qenë në qendër të debatit publik. Rama kundërshton termin “shitje” të Shqipërisë dhe thekson se Sazani vazhdon të jetë pronë e shtetit shqiptar. Sipas tij, ende nuk është finalizuar një marrëveshje për zhvillimin e ish-zonës ushtarake të Sazanit nga investitorë privatë.



HAP I RI PËR BIZNESET KOSOVARE, KOSOVA PJESË E ATA CARNET

PRISHTINË, 20 SHTATOR - Kosova është pranuar në sistemin ndërkombëtar ATA Carnet, duke u krijuar bizneseve kosovare mundësi të reja për qarkullimin e përkohshëm të mallrave dhe pjesëmarrjen në tregjet ndërkombëtare.

Lajmin e ka bërë me dije Oda Ekonomike e Kosovës (OEK), e cila njoftoi se dokumenti ATA Carnet, i njohur si "pasaporta e mallit", do të lëshohet nga OEK-u.

Përmes këtij dokumenti, kompanitë kosovare do të mund të eksportojnë përkohësisht pajisje profesionale, mostra, mallra dhe produkte që përdoren në panaire, ekspozita

dhe aktivitete të tjera jashtë vendit.

Sipas OEK-ut, sistemi ATA Carnet thjeshton procedurat doganore dhe mundëson qarkullimin e përkohshëm të mallrave pa pagesën e detyrimeve doganore dhe taksave të importit, në përputhje me rregullat e vendeve pritëse.

Përfshirja e Kosovës në këtë sistem pritet t'ua lehtësojë kompanive pjesëmarrjen në panaire dhe ekspozita ndërkombëtare, promovimin e produkteve "Made in Kosovo" dhe krijimin e lidhjeve të reja tregtare.

OEK-u e ka cilësuar anëtarësimin në sistemin ATA

Carnet si një hap drejt ndërkombëtarizimit të shërbimeve të saj dhe integritit më të madh të ekonomisë kosovare në tregjet rajonale, evropiane dhe globale. "Anëtarësimi në sistemin ATA Carnet ul barrierat administrative dhe ua lehtëson bizneseve tona daljen në tregjet e huaja, duke krijuar mundësi të reja për eksport, investime dhe rritje ekonomike", thuhet në njoftimin e OEK-ut.

Oda Ekonomike e Kosovës ka bërë me dije se në ditët në vijim do t'i informojë bizneset për procedurat dhe kushtet për përfitimin dhe përdorimin e dokumentit ATA Carnet.



INDUSTRIA NË KOSOVË RRITET 12,47 PËR QIND NË KORRIK

PRISHTINË, 20 SHTATOR- Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) ka publikuar statistikën afatshkurtra të industrisë për muajin korrik 2026, sipas të cilave sektorët e industrisë shënuan rritje prej 12,47 për qind krahasuar me të njëjtin muaj të vitit të kaluar.

Sipas ASK-së, rritja më e madhe sipas aktiviteteve ekonomike u regjistrua në industrinë përpunuese, me 17,01 për qind, ndërsa furnizimi me rrymë, gaz, avull dhe ajër të kondicionuar shënoi rritje prej 3,23 për qind. Në anën tjetër, rënie u regjistrua në sektorin e furnizimit me ujë,



veprimtarive të menaxhimit dhe trajtimit të mbeturinave, me 1,09 për qind, si dhe në industrinë nxjerrëse (minierat dhe guroret), me 3,08 për qind. ASK ka bërë me dije se në korrik 2026, numri i të punësuarve në sektorët e industrisë u rrit me 4,74 për qind krahasuar me korrikun e vitit 2025.

Rritje u shënuar në furnizimin me rrymë, gaz, avull dhe ajër të kondicionuar, me 6,31 për qind; në industrinë përpunuese, me 4,97 për qind; si dhe në furnizimin me ujë dhe aktivitetet e menaxhimit e trajtimit të mbeturinave, me 2,22 për qind.

Ndërkohë, industria nxjerrëse shënoi rënie të numrit të të punësuarve prej 9,58 për qind. Sipas ASK-së, edhe fondi i pagave dhe mëditjeve në sektorët e industrisë shënoi rritje të ndjeshme, prej 17,18 për qind në korrik 2026, krahasuar me të njëjtin muaj të vitit paraprak.

Rritja sipas aktiviteteve ekonomike ishte: industria përpunuese 21,42 për qind; furnizimi me ujë, menaxhimi dhe trajtimi i mbeturinave 12,35 për qind; industria nxjerrëse 6,80 për qind; si dhe furnizimi me rrymë, gaz, avull dhe ajër të kondicionuar 5,51 për qind.

SHQIPËRIA BLEN, POR SHET PAK. IMPORTET RRITEN NË 75.6 MILIARDË LEKË, DEFICITI TREGTAR THELLOHET ME 17.4%

TIRANË, 20 SHTATOR - Gushti është muaji kulmor i verës, kur turizmi është në pikun e tij dhe kërkesa për mallra e shërbime rritet ndjeshëm. Por të dhënat e tregtisë së jashtme tregojnë se kjo kërkesë po ushqen më shumë importet sesa eksportet shqiptare.

Në gusht Shqipëria eksportoi 20.5 miliardë lekë mallra, vetëm 1.6% më shumë se një vit më parë. Në të kundërt, importet arritën në 75.6 miliardë lekë, me një rritje prej 12.6%.

Kjo diferencë e thellon edhe më tej deficitin tregtar që në gusht arriti në 55 miliardë lekë, 17.4% më shumë krahasuar me të njëjtin muaj të vitit të kaluar.

Edhe pse gushti sjell më shumë konsum dhe aktivitete ekonomike, prodhimi vendas nuk po e ndjek me të njëjtin ritëm kërkesën.

Një nga dobësitë kryesore mbetet fasoni. Eksportet e tekstileve dhe këpucëve ranë me 12.4% vetëm në gusht ndërsa për tetë muaj janë tkurrur rreth 8%. Për herë të parë, ky grup nuk është më në krye të eksporteve shqiptare, duke zbritur në vendin e dytë, ndërsa mineralet, lëndët djegëse dhe energjia kanë marrë kryesimin.

Në anën tjetër, importet tregojnë edhe një ndryshim të fortë në burimet e furnizimit. Kina solli 12.5 miliardë lekë



mallra në gusht, duke kaluar Italinë me 10.8 miliardë lekë. Por surpriza më e madhe është SHBA-ja: importet prej saj u rritën rreth 320%, në 5.8 miliardë lekë.

Sa i përket eksporteve, Italia mbetet destinacioni kryesor me 6.8 miliardë lekë, e ndjekur nga Kosova me 2.27 miliardë. Ndërsa eksportet drejt SHBA-së u rritën me rreth 72%, ato drejt Kinës me 49%.

Gushti zgjeroi jo vetëm hendekun mes asaj që Shqipëria blen dhe shet jashtë, por edhe hartën e partnerëve tregtarë teksa BE-ja përbën 63.1% të eksporteve por vetëm 41.6% të importeve.

Rritet paga minimale në Mal të Zi - shkon deri në 1400 euro

PODGORICË, 20 SHTATOR- Qeveria e Malit të Zi ka miratuar programin e ri ekonomik "EURO MODEL", përmes të cilit nga janari pritet të rriten pagat në sektorin publik dhe atë privat.

Paga minimale neto do të jetë 1000 euro për të punësuarit në

vendet e punës që kërkojnë arsimim fillor ose më të ulët, 1,250 euro për ata me arsimim të mesëm dhe 1,400 euro për të punësuarit me arsimim të lartë. Programi përfshin më shumë se 250 mijë të punësuar në Mal të Zi.

Rritje shtesë të pagave mund të

ketë nëse partnerët socialë e pranojnë propozimin e Qeverisë që rritja e vlerës së koeficientit të llogaritjes të zbatohet njësoj në sektorin publik dhe atë privat.

Ndërkohë, nga viti 2027 pensionet do të harmonizohen katër herë në vit. Pensioni

mesatar në prill pritet të kalojë 600 euro, ndërsa pensioni minimal do të jetë mbi 500 euro.

Përveç kësaj, çdo pensionist në dhjetor do të përfitojë edhe 100 euro shtesë për shpenzimet gjatë dimrit.

Modeli i ri ekonomik u miratua



në mbledhjen e Qeverisë dhe pritet t'i dërgohet për shqyrtim

A MUND TË NDALET GARA E ARMATIMIT E INTELIGJENCËS ARTIFICIALE?

Çfarë vlere ka ta fitosh garën e inteligjencës artificiale, nëse gjatë saj humbet kontrollin mbi atë që po krijon? Mes Amerikës dhe Kinës, kjo pyetje përmbledh një dilemë që prek gjithë njerëzimin: ngadalësimi mund t'i japë epërsi rivalit, ndërsa përparimi pa masa të mjaftueshme sigurie mund të sjellë pasoja katastrofike. Teksa konkurrenca teknologjike ndërthuret me fuqinë ushtarake, bota përballet me një sfidë urgjente: si të vendosen kufij të përbashkët, kur askush nuk dëshiron të mbetet pas? Më poshtë shkrimi i revistës “The Economist”...

Dy gjëra duhet t'ju bëjnë të mendoni se çfarë mund të nënkuptojë inteligjenca artificiale për njerëzimin. E para është se vetë njerëzit që punojnë me këtë teknologji po paralajmërojnë se ajo mund të çojë drejt një katastrofe, madje deri në zhdukjen e njerëzimit. E dyta është mënyra se si risitë teknologjike po e përkeqësojnë shkatërrimin e Ukrainës. Këto dy zhvillime japin mësim që bien ndesh me njëri-tjetrin, kur shtrohet pyetja nëse përparimi i vrullshëm i Inteligjencës Artificiale mund apo duhet të ngadalësohet.

Prej vitesh, drejtuesit kryesorë të industrisë së IA-së kanë paralajmëruar se teknologjia e tyre mund të bëhet vdekjeprurëse. Programet mund të bëhen aq inteligjente sa t'ua hedhin krijuesve të tyre, përpara se të jenë “përafuar” me qëllimet dhe etikën e njerëzimit. Njerëz dashakeqë mund ta përdorin IA-në për të mbjellë shkatërrim. Këto paralajmërime janë bërë më të besueshme, pasi agjentë të IA-së, gjatë testimeve, kanë dalë nga mjediset e tyre të izoluar të provës, janë bashkërenduar me njëri-tjetrin dhe kanë depërtuar në sistemet kompjuterike të organizatave, përfshirë edhe një laborator të vetë IA-së. Anthropic, një kompani që zhvillon modele të Inteligjencës Artificiale ka zbuluar njerëz që i përdornin modelin e saj për qëllime të dëmshme: nga shërbimet e fshehta të Malit, që po ndërtonin një sistem mbikëqyrjeje masive, deri te rebelët Huthi në Jemen, të cilët dyshohet se po krijojnë programe kompjuterike për raketa balistike.

Pas dorëheqjes kohët e fundit të një studiuesi të Anthropic, në publik është përhapur frika nga një katastrofë e shkaktuar prej IA-së. Në një postim të parë më shumë se 170 milionë herë, ai tha se kjo kompani dhe OpenAI po “luanin bixhoz me jetët tona”. Inteligjenca Artificiale po bëhet gjithnjë e më e fuqishme, si për mirë, ashtu edhe për keq. Në maj, tregjet e parashikimeve e vlerësonin me më pak se një të tretën mundësinë që IA-ja të zgjidhte përpara vitit 2030 ndonjërin prej problemeve matematikore të Çmimit të Mijëvjeçarit; më 8 shtator, OpenAI tha se kishte zgjidhur njërin prej tyre, duke shkaktuar shqetësim mes matematikanëve.

Më 12 shtator, Sam Altman dhe Elon Musk, dy gjigantë të Inteligjencës Artificiale, mbështetën thirrjen e Dario Amodeit, kreut të Anthropic, për t'i “caktuar një ritëm përparimit në kufijtë e teknologjisë”, pra për të ngadalësuar përparimin e IA-së. Mes mbështetësve të ngadalësimit janë Bernie Sanders, senator i së majtës, dhe Steve Bannon, populist i së djathtës.

Kundërshtarët e alarmizmit të Inteligjencës Artificiale

Mes kundërshtarëve është presidenti Donald Trump, administrata e të cilit i druhet mbi gjithçka humbjes së epërsisë së Amerikës në përballë Kinës, të vetmes rivale serioze të saj. Scott Bessent, sekretari amerikan i Thesarit, ka thënë se, nëse Kina fiton epërsinë “asgjë tjetër nuk do të kishte më rëndësi.” Si provë, Bessent mund të sillte Ukrainën, ku çdo hap në garën e armatimit teknologjik jep pasoja të menjëhershme. Rusia ka përdorur pa mëshirë dronët e saj më të fundit kamikazë për të bombarduar infrastrukturën civile. Përveçse janë më të shpejtë, dronët e saj përdorin njëri-tjetrin si një rrjet komunikimi të ndërlidhur, për të përcjellë informacione dhe komanda. Së shpejti, Rusia do të ketë versionin e vet të rrjetit satelitor Starlink të Musk, duke i bërë më të saktë goditjet e saj me rreze të gjatë. Kjo është dëshmia më e



fundit se sa rëndësi ka në luftë edhe një epërsi e vogël teknologjike. Risitë e vetë Ukrainës në dronët e fushëbetejës kanë ndihmuar në zbrapsjen e valëve të sulmeve ruse. Ukraina mund të godasë thellë në territorin rus me dronë me rreze të gjatë. Të dyja palët po punojnë për grupe dronësh që do të mund të veprojnë me më shumë autonomi, si një sistem i vetëm që përshtatet me rrethanat. Lufta tregon se si teknologjia shndërrohet në fuqi ushtarake, dhe se Rusia e përdor atë pa marrë parasysh rregullat apo normat e vjetra të luftimit. Edhe sikur Amerika të mos i druhej një lufte të ngjashme të drejtpërdrejtë me Kinën, epërsia në Inteligjencë Artificiale do t'i jepte rivalin së saj kryesore gjeopolitike mbizotërim në sulmet kibernetike, spiunazh dhe luftën hibride. Këto nuk janë aftësi që Amerika duhet t'ia lërë në dorë një shteti autoritar, të interesuar për t'i zhdukur idetë liberale. Prandaj, një pezullim do të mund të funksiononte vetëm nëse do ta pranonte edhe Kina. Trump planifikon ta presë presidentin kinez Xi Jinping në Shtëpinë e Bardhë më 24 shtator. Por, edhe sikur Trump të kërkonte një ngadalësim, ka pak gjasa që Xi të pajtohej me planin që përfytyron Amodei, sepse ai do ta “ngete” IA-në kineze në vendin e dytë. Dhe asnjëra

palë nuk mund të rrezikonte që tjetra ta shkelte marrëveshjen duke përparuar me shpejtësi. Për të arritur një marrëveshje, secila palë do të duhej të verifikonte respektimin e marrëveshjes, siç ndodhte me kontrollin e armëve gjatë Luftës së Ftohtë. Amerika, Britania dhe Bashkimi Sovjetik i ndaluan provat bërthamore në atmosferë në vitin 1963, sepse mund t'i zbulonin ato; provat në fshehtësivazhduan edhe për tre dekada të tjera, derisa u bë i mundur edhe monitorimi i tyre. Fatkeqësisht, megjithëse qendrat e të dhënave janë të dukshme, nuk ekziston ndonjë metodë e verifikueshme për të parë çfarë ndodh brenda tyre. Një infrastrukturë që trajnon një superinteligjencë mund të paraqitet si një sistem chatbot-ësh që u përgjigjen pyetjeve të përditshme. Mundësitë për një marrëveshje mbi sigurinë e Inteligjencës Artificiale janë, pra, të kufizuara; por ato ekzistojnë. Më shumë transparencë do të ndihmonte. Të dyja palët duhet të zotohen se do t'i bëjnë publike dhe do t'i hetojnë incidentet e sigurisë në laboratorët e tyre, duke zbatuar legjislacionin vendas. Secila mund të tregojë se e merr seriozisht sigurinë, për të ndërtuar besim dhe për t'i hapur rrugën palës tjetër të marrë masa parandaluese. Ato

duhet gjithashtu t'i bëjnë trysni njëra-tjetrës për të përmirësuar sigurinë kibernetike të laboratorëve, në mënyrë që agjentët e IA-së të mos dalin aq lehtë nga mjediset e izoluar të provës, dhe për të garantuar që, nëse ndonjëri del, laboratori i tij të mbajë përgjegjësi financiare.

Më e rëndësishmja është sfida për të garantuar që IA të veprojë në interes të njerëzve. Amerika dhe Kina kanë vlera shumë të ndryshme, por të dyja e dinë se të qenët në krye nuk ka asnjë dobi nëse kjo sjell zhdukjen e njerëzimit. Ato duhet të zotohen se do të ndajnë mes tyre punën për ato aspekte të përafrimit të IA-së me interesat njerëzore që nuk japin ndonjë avantazh konkurrues. Njohuritë mbi metodat më të mira të vlerësimit dhe teknikat e mbajtjes nën kontroll janë një e mirë publike globale. Nëse njëra palë arrin një përparim të rëndësishëm në siguri, nuk ka kuptim ta mbajë vetëm për vete.

Katastrofizëm efektiv

Disa e hedhin poshtë valën e fundit të parashikimeve katastrofike, duke e quajtur një dredhi marketingu të kompanive të IA-së, apo madje një përpjekje për të frenuar konkurrencën. Megjithatë, përparimi i IA-së është mjaftueshëm i shpejtë, incidentet e sigurisë mjaftueshëm rrëqethëse dhe paralajmërimet e kompanive mjaftueshëm të hershme e të vazhdueshme, sa të merren seriozisht. IA-ja nuk ka nevojë të vrasë çdo njeri për të shkaktuar një katastrofë. Një tufë agjentësh të OpenAI vuri në shënjestër një kompani teknologjike: po sikur herën tjetër të sulmojë një rrjet elektrik apo një sistem armësh? Ajo mund të jetë madje aq inteligjente sa t'u shmanget përpjekjeve për ta çaktivizuar. Bota duhet të veprojë urgjentisht për ta parandaluar këtë rrezik. Megjithatë, demokracitë duhet të shmangin edhe humbjen e kontrollit në favor të regjimeve autoritare. Këto janë detyra të vështira dhe që bien ndesh me njëra-tjetrën. Në fund, ato mund të çojnë në luftë. Vështirë të imagjinohet se mund të vihej më shumë në rrezik. / The Economist – Bota.al



N.P.L. PALLATI I RINISË SH.A.
Prishtinë – Kosovë, Luan Haradinaj, p.n.
e-mail: contact@pallatirinese.com
www.pallatirinese.com



Në bazë të dispozitave të nenit 21, pikës 21.4 të Ligjit nr. 03/L-087 Për Ndërmarrjet Publike, gjegjësisht nenit 13 të Ligjit nr. 04/L-111 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr.03/L-087 Për Ndërmarrjet Publike dhe në bazë të nenit 17 të Statutit, Bordi i Drejtorëve i N.P.L. PALLATI I RINISË SH.A., me datë 11.09.2026 bazuar mbi Vendimin Nr. 1/2058 publikon këtë:

KONKURS PUBLIK Për plotësimin e një (1) pozite

1. Titulli i punës: Këshilltar/e i/e Përgjithshëm – Sekretar/e Korporativ/e Vendi: Prishtinë.

Ndërmarrja: N.P.L. PALLATI I RINISË SH.A. me seli në Prishtinë.
I përgjigjet: Bordit të Drejtorëve.
Mandati: 3 vite
Koeficienti: 5.9

2. Kushtet dhe kualifikimet e kërkuara:

Bordi i Drejtorëve, dëshiron të sigurohet që të gjithë kandidatët potencial të jenë persona me integritet të lartë të cilët i plotësojnë kushtet e kualifikimit sipas nenit 17.1, (ii) i plotësojnë kriteret e pavarësisë sipas nenit 17.2, pikat (d), (f), (j), (k) dhe (l) (iii) nuk janë, ose në çfarëdo kohe gjatë periudhës tridhjetë e gjashtë (36) muajsh para datës së aplikimit nuk kanë qenë Drejtorë të Bordit të kompanisë gjegjëse dhe (iv) kanë përvojën e nevojshme profesionale dhe shkollimin e kërkuar për pozitën në fjalë; Çdo person i cili dëshiron të merret parasysh për një pozitë të drejtorit duhet që po ashtu t'i përmbushë edhe kushtet e përshtatshmërisë profesionale në vijim:

- Të posedojë diplomë universitare -Fakulteti Juridik (jurist i diplomuar ose master në shkenca juridike);
- Të posedojë së paku pesë (5) vite përvojë profesionale nga fusha e qeverisjes korporative ose të drejtës së shoqërive tregtare;
- Të plotësojë kushtet e kualifikimit sipas nenit 17.1 si dhe të plotësojë kriteret e pavarësisë sipas nenit 17.2 pikat (d),(f),(j),(k),(l) të Ligjit nr. 03/L-087 të Ndërmarrjeve Publike dhe Plotësim Ndryshimit të LNP nr. 04/L-111 neni 13;
- Aftësi për punë ekipore;
- Të ketë aftësi të mira komunikuese;
- Të ketë etikë në punë dhe integritet.
- Të posedojë njohuri të punës me kompjuter;
- Njohja e gjuhës angleze (e dëshirueshme);
- Dëshmitë mbi njohuritë dhe të arriturat tjera do të mirren në konsideratë dhe vlerësohen konform relevancës me vendin e punës;
- Të jetë person me integritet të lartë dhe të plotësojë të gjitha kushtet e përshtatshmërisë të parapara me neni 17 të Ligjit të Ndërmarrjet publike nr. 03/L-087 , dhe plotësim ndryshimit përkatës,Ligji për Parandalimin e konfliktit të interes në ushtrimin e funksionit public nr/06L-011, si dhe me normat tjera positive relevante.

3. Këshilltar/e i/e Përgjithshëm – Sekretar/e Korporativ/e ka këto detyra dhe përgjegjësi:

- Sigurohet që të përcillen procedurat e Bordit, ku bëjnë pjesë organizimi i takimeve të Bordit, Komiteteve të Bordit dhe Aksionarëve duke përfshirë (në bashkëpunim me Kryesuesin) përgatitjen dhe shpërndarjen e agjendave;
- Mban regjistrin e aksionarëve;
- Koordinon me KE përgatitjen e materialit për mbledhjet e Bordit të Drejtorëve;
- Mban procesverbalin e mbledhjeve të Bordit të Drejtorëve dhe Komitetit të Auditimit (nëse nuk kërkohet ndryshe nga kryesuesit e tyre) dhe i regjistron në librat e protokolleve;
- Shpërndan procesverbalet tek drejtorët dhe aksionarët;
- Merret me regjistrimin zyrtar të ndryshimeve të cilat kërkohen sipas ligjit, i regjistron në regjistrin e Kosovës për shoqëritë tregtare dhe emrat tregtarë;
- Sipas udhëzimeve nga Kryesuesi, përgjegjësitë e Sekretarit përfshijnë sigurimin e rrjedhjes së mirë të informatave brenda Bordit dhe komiteteve të tij dhe në mes të Bordit dhe menaxherëve të lartë të Ndërmarrjes;
- Këshillat dhe shërbimet e Sekretarit duhet të jenë në dispozicion të të gjithë drejtorëve i cili njëheri është përgjegjës tek Bordi për të siguruar që përputhen procedurat e Bordit;
- Përcjell ndryshimet ligjore që kanë të bëjnë me ndërmarrjen duke informuar Bordin dhe menaxhmentin e kompanisë për ndryshimet si dhe përgatitë udhëzimet e nevojshme për menaxhmentin e kompanisë.Merret edhe me çështjet tjera të qeverisjes korporative sipas nevojës.

4. Informatë për procedurën e konkurimit

- Kandidatët e interesuar për këtë vend pune duhet të bashkangjesin këto dokumente:
- Formulari i kërkesës për punësim (aplikimit);
- Kopje e letërnjoftimit; CV ; Çertifikata e lindjes;Letër motivimi;
- Dëshmitë mbi Shkollimin dhe kualifikimin profesional e noterizuar;
- Diplomën nga universitetet e huaja duhet të jenë të nostrifikuara nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe e noterizuar.
- Dëshmi për përvojën e punës/vërtetim i lëshuar nga institucioni përkatës i punësimit për përvojën e punës, që përcakton pozitën e punës si dhe kohëzgjatjen e angazhimeve në atë pozitë;
- Pasqyrat e kontributeve pensionale (nuk kërkohet për përvojat e punës para themelimit të Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës, dhe për ato përvoja kur punëdhënësit nuk kanë qenë të detyruar të paguajnë në këtë institucion);
- Deklarata nën betim sipas neneve 17.1 dhe 17.2 të Ligjit të NP e cila mundë të shkarkohet nga uebfaqja e Kompanisë;
- Certifikatë nga gjykata kompetente që nuk është duke u zhvilluar procedurë penale dhe që nuk është i dënuar për kryerjen e ndonjë veprë penale (jo më e vjetër se 6 (gjashtë) muaj nga data e lëshimit);
- Lista e dokumenteve të dorëzuara.

5. Afati i Konkursit:

Konkursi publik është i hapur në kohëzgjatje prej 30 (tridhjetë) ditë kalendarike nga data **11.09.2026 deri më 10.10.2026**

Të interesuarit mund t'i dorëzojnë kërkesat (aplikacionet) e tyre me dokumentet tjera relevante në emailin: burimetnjerezore@pallatirinese.com

Formulari për kërkesë (aplikim) dhe Deklarata nën betim, mund të shkarkohen nga ueb-faqja e N.P.L. PALLATI I RINISË SH.A. me seli në Prishtinë në <http://www.pallatirinese.com/> ose mund të merren në zyrat e Ndërmarrjes.

6. Vërejtje:

Kandidatët me dokumentacion të pakompletuar, të paplotësuar dhe jo-adekuat dhe jashtë afatit të konkurimit, do të refuzohen.

Do të kontaktohen vetëm kandidatët të cilët i plotësojnë kriteret e përcaktuara dhe përfshihen në listën e ngushtë.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government
Ministria e Drejtësisë-Ministraskvo Pravde-Ministry of Justice



Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar
Agencija za Upravljanje Zoplenjenom i Konfiskovanom Imovinom
Agency for Administration of Sequestered and Confiscated Assets

Ftesë për Ankand Publik Rishpallje

Datë 18.09.2026

Referenca: AAPSK – 010/2026

AAPSK- njofton të gjithë të interesuarit se ofron për shitje mallin si në vijim, sipas lëndës së paraqitura më poshtë:


N r	Përshkrimi	Sipërfaqja (m²)	Çmimi fillestar	Çmimi nga ofertuesi
1	Vilë model 'Zyre' P+0- Rishpallje	42.2 m²	4.700.00€	

Oferta e nënshkruar, vulosur dhe e mbyllur në zarf duhet të dorëzohen më së largu deri me **23.09.2026** në ora **11:00** në Zonën Kadastrale, Çagllavicë,-në adresë: IT Group Shpk Maxhistrala Prishtinë- Ferizaj- KK Graçanicë.

Të interesuarit mallin mund ta shikojnë me datë: **23.09.2026**, prej orës **10:00-11:00** në Zonën Kadastrale, Çagllavicë,-në adresë: IT Group Shpk Maxhistrala Prishtinë- Ferizaj- KK Graçanicë.

Pasuritë e sekuestruar ose të konfiskuara në këtë procedurë shitje procedohen për shitje, me çmimin e lartë cekur në gjendjen siç janë. Të drejtë pjesëmarrjeje kanë të gjithë personat fizik dhe juridik. Personat juridik të cilët marrin pjesë duhet që me veti të sjellin Certifikatën e regjistrimit të biznesit, kurse personat fizik kopjen e letërnjoftimit personal. Fitues do të jetë oferta e ofruar me çmimin më të lartë. Të interesuarit mund të tërheqin dokumentacionin e ankandit-listën e artikujve në zyrën nr. 1012, prej orës 08:00-16:00, ose mund të shkarkohen në web faqen e AAPSK-se në: <https://aapsk.rks-gov.net> apo <https://md.rks-gov.net/>.

Në zarf të shkruhet për: AAPSK, Divizioni i Shitjes; oferta mos të hapet para orës 12:00.Adresa: Ministria e Drejtësisë, Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar Ish Pallati i Rilindjes, kati 10, Divizioni i Shitjes nr. 1012, Prishtinë, tel 038 200 67 254



N.P.L. PALLATI I RINISË SH.A.
Prishtinë – Kosovë, Luan Haradinaj, p.n.
e-mail: contact@pallatirinise.com
www.pallatirinise.com
Na osnovu odredbi člana 21, tačke 21.4 /zakona br. 03/L-087 o javnim preduzećima, odnosno člana 13 Zakona br. 04/L-111 o izmenama i dopunama Zakona br. 03/L-087 o javnim preduzećima i na osnovu člana 17 Statuta, Upravni odbor N.P.L. PALATI I RINISE AD, od 11.09.2026. godine, na osnovu Odluke Br. 1/2058 objavljuje ovo:

JAVNI KONKURS

Za popunjavanje jedne (1) pozicije
1. Naziv radnog mesta: Generalni savetnik - Sekretar preduzeća
Lokacija: Priština.
Preduzeće: N.P.L. PALATI I RINISE AD sa sedištem u Prištini.
Odgovoran: Upravnom odboru.
Mandat: 3 godine
Koeficijent: 5.9

2. Generalni savetnik - Sekretar preduzeća ima sledeće dužnosti i odgovornosti: Upravni odbor želi da osigura da svi potencijalni kandidati budu osobe visokog integriteta koje ispunjavaju kvalifikacione uslove iz člana 17.1, (ii) ispunjavaju kriterijume nezavisnosti iz člana 17.2, tačke (d), (f), (j), (k) i (l) (iii) nisu, ili u bilo kom trenutku tokom trideset šest (36) meseci pre datuma podnošenja zahteva nisu bili, direktori Upravnog odbora relevantne kompanije i (iv) imaju neophodno stručno iskustvo i obrazovanje potrebno za predmetnu poziciju; Svako lice koje želi da bude razmatrano za poziciju direktora mora takođe ispunjavati sledeće uslove stručne podobnosti:

- Posedovati univerzitetsku diplomu - Pravni fakultet (diplomirani pravnik ili master pravnih nauka);
- Posedovati najmanje pet (5) godina stručnog iskustva u oblasti korporativnog upravljanja ili kompanijskog prava;
- Ispunjavati kvalifikacione uslove iz člana 17.1 i ispunjavati kriterijume nezavisnosti iz člana 17.2, tačke (d), (f), (j), (k), (l) Zakona br. 03/L-087 o javnim preduzećima i izmene ZJP br. 04/L-111, član 13;
- Sposobnost za timski rad;
- Posedovati dobre komunikacijske veštine;
- Posedovati radnu etiku i integritet.
- Posedovati računarske veštine;
- Znanje engleskog jezika (poželjno);
- Dokazi o drugim znanjima i dostignućima biće uzeti u obzir i procenjeni u skladu sa relevantnošću za posao;
- Biti osoba sa visokim integritetom i ispunjavati sve uslove podobnosti utvrđene članom 17 Zakona o javnim preduzećima br. 03/L-087 i relevantnim izmenama, Zakonom o sprečavanju sukoba interesa u vršenju javnih funkcija br. 06L-011, kao i drugim relevantnim pozitivnim normama.

3. Generalni savetnik - Sekretar kompanije ima sledeće dužnosti i odgovornosti:

- Osigurati da se poštuju procedure Odbora, uključujući organizaciju sastanaka Odbora, odbora Odbora i akcionara, uključujući (u saradnji sa predsednikom) pripremu i distribuciju dnevnog reda;
- Voditi registar akcionara;
- Koordinirati sa Izvršnom komisijom pripremu materijala za sastanke Odbora direktora;
- Voditi zapisnike sa sastanaka Odbora direktora i Odbora za reviziju (osim ako njihovi predsednici ne zahtevaju drugačije) i evidentirati ih u zapisnicima;
- Distribuirati zapisnike direktorima i akcionarima;
- Obavljati zvaničnu registraciju promena koje zahteva zakon, evidentirajući ih u Kosovskom registru trgovačkih društava i trgovačkih imena;
- Prema uputstvima predsednika, odgovornosti Sekretara uključuju obezbeđivanje nesmetanog protoka informacija unutar Odbora i njegovih odbora i između Odbora i višeg menadžmenta Kompanije;
- Saveti i usluge Sekretara biće dostupni svim direktorima i biće odgovoran Odboru za obezbeđivanje usklađenosti sa procedurama Odbora;
- Prati pravne promene koje se odnose na Društvo tako što obaveštava Upravni odbor i rukovodstvo Društva o promenama i priprema neophodna uputstva za rukovodstvo Društva. Takođe se bavi i drugim pitanjima korporativnog upravljanja po potrebi.

4. Informacije o postupku konkursa

- Kandidati zainteresovani za ovaj posao moraju priložiti sledeća dokumenta:
- Obrazac za prijavu za zaposlenje;
- Kopiju lične karte; CV; Izvod iz matične knjige rođenih;
- Motivaciono pismo;
- Overeni dokaz o obrazovanju i stručnoj kvalifikaciji;
- Diplome stranih univerziteta moraju biti overene od strane Ministarstva prosvete, nauke i tehnologije.
- Dokaz o radnom iskustvu/ potvrda izdata od strane nadležne institucije za zapošljavanje o radnom iskustvu, kojom se utvrđuje radno mesto i trajanje angažovanja na tom mestu;

4. Informacije o postupku konkursa

- Kandidati zainteresovani za ovaj posao moraju priložiti sledeća dokumenta:
- Obrazac za prijavu za zaposlenje;
- Kopiju lične karte; CV; Izvod iz matične knjige rođenih;
- Motivaciono pismo;
- Overeni dokaz o obrazovanju i stručnoj kvalifikaciji;
- Diplome stranih univerziteta moraju biti overene od strane Ministarstva prosvete, nauke i tehnologije.
- Dokaz o radnom iskustvu/ potvrda izdata od strane nadležne institucije za zapošljavanje o radnom iskustvu, kojom se utvrđuje radno mesto i trajanje angažovanja na tom mestu;
- Izjave o penzijskim doprinosima (nisu potrebne za radna iskustva pre osnivanja Kosovskog fonda za penzijsku štednju, i za ona iskustva kada poslodavci nisu bili u obavezi da plaćaju ovoj instituciji);
- Izjava pod zakletvom u skladu sa članovima 17.1 i 17.2 Zakona o JP koja se može preuzeti sa veb stranice Kompanije;
- Potvrda nadležnog suda da se ne vodi krivični postupak i da lice nije osuđivano za bilo koje krivično delo (ne starija od 6 (šest) meseci od datuma izdavanja);
- Spisak podnetih dokumenata.

5. Rok za konkurs:

Javni konkurs je otvoren u periodu od 30 (trideset) dana od 11.09.2026 do 10.10.2026. Zainteresovana lica mogu podneti svoje prijave sa ostalom relevantnom dokumentacijom na imejl adresu: burimetnjerezore@pallatirinise.com
Obrazac za prijavu i izjava pod zakletvom mogu se preuzeti sa veb stranice N.P.L. PALATI I RINISE AD sa sedištem u Prištini na <http://www.pallatirinise.com/> ili se mogu dobiti u kancelarijama Kompanije.

6. Napomena:

Kandidati sa nepotpunom, nekompletnom i neadekvatnom dokumentacijom i van roka za konkurs biće odbijeni.
Biće kontaktirani samo kandidati koji ispunjavaju navedene kriterijume i koji su uvršteni u uži izbor.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Halë Berisha shpall të pavlefshme dëftesat e shkollës së mesme “Remzi Ademaj” Prizren, diplomën dhe dëftesën e provimit.
- Bosnalijek farmaceutska i Hemijiska Industrija dionicko Društvo Kosova Branch Dega në Kosovë, shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. 810122309.
- “Master Build SRL Dega në Kosovë” shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. Unik Identifikues: 811932583.
- Thot Ratkoceri shpall të pavlefshme dëftesat si dhe diplomën e shkollës së mesme “28 Nëntori” shkolla Teknike Prishtinë.
- Driton Bucaj shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shfmu “ Abdyl Frasheri “ Prizren.
- Armend Hoxhaj shpall te pavlefshme 3 dëftesat dhe diplomën Q K “11 Marsi “ Prizren.
- Trim Reznici shpall të pavlefshme dëftesën e kl.10 të sh.m.p “Gjon N. Kazazi” Gjakovë.
- Sokol Haxhikadrija shpall të pavlefshme diplomën e gjimnazit “Hajdar Dushi” Gjakovë.
- Elidon Pylla B.I. shpall të pavlefshme certifikatën e TVSH-së, me nr. 33049408.
- Elidon Pylla B.I. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. 811149542 të lëshuar nga ARBK.
- Genti Kurhasku shpall të pavlefshme certifikatën e maturës shtetërore të sh.m. mjekësisë “Hynsi Zajmi” Gjakovë.
- Sebastian Prenka shpall të pavlefshme dëftesën e plotë shf.f.m.u “Ahmet Rrustemi” Bec Gjakovë nga kl. 1-5 dhe 6-9.
- Xhelal Halilosmani shpall të pavlefshme dëftesat dhe diplomën e sh.m. Ekonomike “Kadri Kusari” Gjakovë.
- Diana Morina shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 1.2.3.4 dhe diplomën e Gjimnazit “Hajdar Dushi” Gjakovë.
- Albana Gjocaj nga Juniku shpall të pavlefshme diplomën e universiteti Publik “Fehmi Agani” Gjakovë, drejtimi Infermieri, Bachelor me nr. 104.
- Atdhe Gashi shpall të pavlefshme dëftesat diplomën si dhe certifikatën e diplomës të shkollës së mesme Teknike “28 Nëntori” Prishtinë.
- Valmir Karavidaj shpall të pavlefshme dëftesën e shkollës fillore “Gjergj Kastrioti” në Mazdrek.
- Elton Halili shpall të pavlefshme dëftesën e klasës së 11 të shkollës së mesme të lartë të mjekësisë “Dr. Xheladin Deda”.

MEKA
®
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA 1992





ROYAL CROWN
RC
cola

ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales